# DËSHMI ARKIVI

**A-435723**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Spiunazh dhe sabotazh/ 31-vjeçari britanik akuzohet se i kaloi Rusisë të dhëna për fabrikat e dronëve |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/spiunazh-dhe-sabotazh-31-vjecari-britanik-akuzohet-se-i-kaloi-rusise-te-dhe-i585275` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 10 shtator 2026, 19:24:28 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 10 shtator 2026, 20:15:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9f0a799089b588f9b3d97aca30d2a9eec80c24eb51c1f331486faabb64b0dde9` |
| TEKSTI | `98b07ddf60d5740d5f980f489cc09bc61e9ac8587f659bb507ca3f287b693582` |
| PAMJA | `9b2cf7f85fe23ce5a9c9fba8beca1a4865d76cc88e4c9bfb67bf0d7a1e46a0f6` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `517705f4ff945cac25bd198f42cd7e2d2aba96c78cd4736d6f79f95c30ec8b02` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `542a3a3db8837abd67a91c70b58dc4a8c438063f1e082ebd959a0e7f73c23349` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/517705f4ff945cac25bd198f42cd7e2d2aba96c78cd4736d6f79f95c30ec8b02`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Spiunazh dhe sabotazh/ 31-vjeçari britanik akuzohet se i kaloi Rusisë të dhëna për fabrikat e dronëve

10 Shtator 2026, 22:15Bota TEMA

Spiunazh dhe sabotazh/ 31-vjeçari britanik akuzohet se i kaloi

Një 31-vjeçar nga Swindon, në jug të Anglisë, është paraqitur në gjykatë në Londër, pasi akuzohet se ka kaluar informacione për fabrikat e prodhimit të dronëve te persona të lidhur me inteligjencën ushtarake ruse.

Joshua Cammidge është akuzuar për dy vepra penale në bazë të Ligjit britanik për Sigurinë Kombëtare. Prokuroria e akuzon për ndihmë ndaj një shërbimi të huaj inteligjence dhe për përgatitje për kryerjen e një akti sabotazhi. Sipas akuzave, Cammidge ka dërguar pamje nga Google Maps, ku kishte shënuar vendndodhjen e një fabrike dronësh dhe katër objekte të tjera që lidhen me prodhimin e tyre në Swindon.

Prokurorët thonë gjithashtu se 31-vjeçari kishte ofruar të kryente vetë një akt sabotazhi. Ai dyshohet se kishte kërkuar informacione për një pajisje që mund të bllokojë sinjalet Wi-Fi dhe se kishte vizituar personalisht disa prej objekteve.

Sipas Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës në Britani, informacionet dyshohet se i janë dhënë një personi që besohet të ketë lidhje me të ashtuquajturin GRU Volunteer Corps, grup që autoritetet britanike e përshkruajnë si të kontrolluar nga shërbimi i inteligjencës ushtarake ruse, GRU.

Hetuesit thonë se veprimet e dyshuara kanë ndodhur nga fundi i marsit deri në fillim të shtatorit të këtij viti. Frank Ferguson, prokuror i lartë në sektorin e krimeve të rënda dhe kundër terrorizmit, tha se vendimi për ndjekjen penale u mor pas një hetimi të kryer nga policia kundër terrorizmit.

Cammidge nuk pranoi të deklarohej në seancën e zhvilluar në Westminster Magistrates' Court dhe u la në paraburgim. Çështja është dërguar në Old Bailey, gjykata kryesore penale e Londrës, ku ai pritet të paraqitet sërish më 25 shtator.

Rasti vjen në një periudhë tensionesh të larta mes Britanisë dhe Rusisë. Marrëdhëniet mes dy vendeve janë dëmtuar prej vitesh nga raste të tjera, përfshirë helmimin e Alexander Litvinenkos në vitin 2006 dhe sulmin me agjent nervor në Salisbury në vitin 2018 ndaj ish-oficerit rus Sergei Skripal.

Britania është një nga mbështetëset kryesore evropiane të Ukrainës që prej pushtimit rus të vitit 2022. Ndërkohë, Swindon është kthyer në një qendër të rëndësishme për prodhimin e dronëve ushtarakë në Britani, duke e bërë zonën me interes të veçantë për autoritetet e sigurisë.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Sulm me thikë në Londër, katër persona plagosen në një përleshje në rrugë

20:55 Bota / 2 komente

Bie zjarr në një anije në Kinë, 20 viktima

20:35 Bota

Presidenti i Mongolisë habit ushtarët! 58-vjeçari ngre 100 kg peshë, pamjet bëhen virale

19:55 Bota / 4 komente

Arrestohen spiunët e Iranit/ Londër, një burrë dhe një grua punonin për shërbimin sekret iranian

19:35 Bota / 1 koment

Trump premtoi 5 mijë dollarë për çdo amerikan nëse republikanët fitojnë zgjedhjet, por sa i ligjshëm është shpërblimi?

18:35 Bota / 2 komente

Skandal me "Call-Centerat" në Ukrainë, DW: Të përfshirë zyrtarë të Prokurorisë!

16:55 Bota

Reforma brenda BE: Plani franko gjerman drejt miratimit, plani që favorizon Shqipërinë

16:45 Bota / 2 komente

Algjeria ndërpret marrëdhëniet diplomatike me Emiratet e Bashkuara Arabe

16:15 Bota

Turqia dhe 7-të vende të tjera mbështesin sanksionet britanike ndaj vendbanimeve izraelite në Bregun Perëndimor

16:05 Bota

Gjermania gati planin, synon të fusë Inteligjencën Artificiale në operacionet ushtarake

15:35 Bota / 1 koment

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**"Berisha gënjeu demokratët" - Bejko: Nuk ka më të drejtën...**

09:45 Politika / 16 komente

**VIDEO/ Protestuesit nuk kursejnë as qytetarët, sulmojnë n...**

21:12 Politika / 80 komente

**Plas në PD, Çim Peka sulmon Belind Këlliçin: Ky idioti po...**

15:45 Politika / 18 komente

**Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...**

13:04 Politika / 49 komente

**Përçarja në protestë, Balla i përshëndet nga Paskuqani pa...**

22:10 Politika / 3 komente

## Blog Tema

**Një telash më shumë për Partinë Demokratike**

19:10 Blog / 4 komente

**Kur protesta nuk shqetëson pushtetin, por merr peng qytetarin**

18:28 Blog / 12 komente

**Sikur Lana të mbyste bulevardin me baltë**

17:05 Blog / 6 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by

- Politika
- Kronika
- Editorial
- Blog
- Bota
- Sport
- Shëndeti
- Turizëm
- Sociale
- Ekonomia
- Antena
- Rajoni
- Kulturë
- Lifestyle
- Dossier
- Hi-Tech

- Kontakt
- Te dhënat personale
- Cookies

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.